



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË**

---

**KDHSH.II.nr.1268/22**

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË**, me gjyqtaren Franciska Zhitja-Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Gjykata Themelore në Prizren, kundër debitorit N.T.SH “L...”, me seli në Prizren, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit, E.R , avokat nga Prizreni, në procedurën e përmbarimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarës së debitorit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, CP.nr.54/2019, i datës 03.06.2021, me datë 06.09.2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**HEDHET** poshtë si e pasafatshme ankesa e të autorizuarit të debitorit N.T.SH “L...”, me seli në Prizren, e paraqitur aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, CP.nr.54/2019, i datës 03.06.2021.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar CP.nr.54/2019, i datës 03.06.2021, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit N.T.SH “L...”, me seli në Prizren, të parashtruar kundër aktvendimit për përmbarim CP.nr.54/2019 të datës 17.01.2019 dhe ka mbetur në fuqi i njëjti urdhër për përmbarim.

Kundër këtij aktvendimi ka parashtruar ankesë e autorizuar e debitorit për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të se drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit N.T.SH “L...”, nga Prizreni në mënyrë që të ndryshojë aktvendimin e ankimuar, në atë mënyrë që do të shfuqizojë vendimin për pagimin e gjobave ose të anulojë aktvendimin dhe të kthejë në rigjykim

Gjykata Komerciale e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 dhe 209 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

**Ankesa është e është e pa afatshme.**

Dhoma e Shkallës së Dytë duke vlerësuar lejueshmërinë e ankesës së ushtruar nga ana e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të ankimuar të nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prizren -Departamenti i Përgjithshëm, me shenjën CP.nr.54/2019, të datës 03.06.2021, ka konstatuar se ankesa është paraqitur pas kalimit të afatit kohor ligjor të dhënë në këshillën juridike të aktvendimit të ankimuar prej 7 ditësh, duke llogaritur nga dita e pranimit në dorëzim të të njëjtit aktvendim nga debitori.

Tek një përfundim i tillë kjo gjykatë vjen për faktin se në fletë kthesën e cila gjendet si dëshmi në shkresat e lëndës konstatohet se debitorët aktvendimin e ankimuar e kanë pranuar në mënyrë të rregullt me datën 07.06.2021 (ditë e hëne), ndërsa ankesën kundër të njëjtit aktvendim, e ka dorëzuar në gjykatë përmes postës me datë 15.06.2021 (ditë e martë), që vërtetohet nga vula e dorëzimit në postë, ndërsa me datën 16.06.2021 (ditë e mërkurë) është pranuar në gjykatë me të cilën vërtetohet nga vula e pranimit të gjykatës e cila është vendosur në ankesën e dorëzuar tek e njëjta gjykatë.

Afati kohor ligjor për ushtrim të ankesës ka qenë afati prej 7 ditësh siç është dhënë edhe në këshillën juridike, i cili ligjërisht ka filluar të rrjedhë nga dita e nesërme prej kur debitori e ka pranuar aktvendimin e ankimuar, që në rastin konkret i bie të ketë filluar nga data 08.06.2021, e ku me shikim në kalendarin mujor – qershor për vitin 2021, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e ankesës – duke marrë afatin e dhënë në këshillën juridike ka qenë data 14.06.2021 (ditë e hëne), datë kjo kur edhe ka skaduar afati kohor ligjor prej 7 ditësh i dhënë në këshillën juridike. Nga kjo rezulton se debitori ka paraqitur ankesë 1 ditë me vonesë, pra jashtë afatit kohor.

Afatet kohore të përcaktuara me ligj, janë të pandryshueshme dhe nuk mund të zgjaten apo shkurtohen as me vendim të gjykatës e as me marrëveshjen e palëve. Afati ligjor ka karakter prekluziv, sepse veprimi procedural i lidhur për afatin ligjor nuk mund të kryhet pas skadimit të tij.

Dhoma e Shkallës së Dytë në kuptim të rrethanave të paraqitura më lart gjen se ankesa është e palejueshme pasi që me dispozitën e nenit 77 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, përcaktohet se: *“Ankesa kundër vendimit mbi prapësimin parashtrohet përmes Gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit”,* si dhe në bazë të nenit 186 paragrafi 2 të LPK-së është e paraparë se *“Ankesa është e pa afatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj”,* ndërsa me dispozitën e nenit 196 përcaktohet se *“Ankesën e vonuar, jo të plotë, apo jo të lejueshme e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç është parashikuar në nenin 186 të LPK-së”.*

Kështu në shkresat e lëndës nuk ekziston ndonjë provë me të cilën do të konfirmohej se ankesa është dorëzuar në ndonjë datë tjetër, prandaj nga arsyet e mësipërme, Gjykata Komerciale

Dhoma e Shakllës së Dytë në Prishtinë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi pasi që gjeti se ankesa e debitorit është e pa afatshme, të cilën kjo gjykatë e hedhë poshtë në pajtim me nenin 77 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, si dhe nenin 186 paragrafi 2, 196 dhe 209 pika (a) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**KDHSH.II.nr.1268/22, me datë 06.09.2022**

**Gjyqtarja,**  
Franciska Zhitija Ymeri, d.v